



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Numri i Çështjes	31154-00982-80-2019	Data e Regjistrimit	2/12/2019
Numri i Vendimit	80-2019-1101	Data e Vendimit	5/2/2019

VENDIM NE EMER TE REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane E PERBERE NGA:

KRYESUES: Gentiana Muçaj

ANËTAR

SEKRETARE Mendurije Hasko

Objekti: Shfuqizimin e Aktit administrative, Proces-verbalit te Konstatimit te Shkeljes, date 29.01.2019, numer serie nr. 8118560, te Komisarariatit te Policise Rrugore Tirane, si dhe Vendimin nr. 1275, date 05.02.2019 "Per shqyrtimin e kundervajtjes" te Drejtorise Vendore te Policise Tirane, per vendosjen e gjobes ne shumen 40000 (dyzetemije) leke, dhe pezullimin e lejes se drejtimit te automjetit ndaj paditesit [REDACTED]

Baza Ligjore : Nenet 31, 32/a, 154 e 156 te Kodit te Procedures Civile, nenet, 7/ 'a', 15/ 'a', 16/'b' dhe 17/'a', te ligjit Nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gj.Administrative etj. ", Ligji nr. 10279, date 20.02.2010 "Per Kundervajtjet Administrative", si dhe Ligji nr. 8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor", i ndryshuar.

Përmbledhja e vendimit:

Në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes, te zhvilluar në prani të paditesit Shkezen Byberi dhe ne mungese te pales se paditur te e cila kishte dijeni per daten dhe oren e seances gjyqesore dhe pa shkaqe te arsyeshme nuk u paraqit ne senace gjyqesore ,pasi analizoi provat e paraqitura nga palet dhe bisedoi çështjen ne teresi dhe degjoi pretendimet perfundimtare te pales paditese e cila kërkoi pranimin e kerkese padise

Vëren:

Paditës [REDACTED] ka paraqitur përpara Gjykatës një kërkesë padi me objekt: Shfuqizimin e aktit administrative procesverbalit te konstatimit te shkeljes date 29.01.2019 me nr serie 8118560 te komisarariatit Rajonal te policise Rreugore Tirane si dhe te vendimit nr 1275 date 05.02.2019 "per shqyrtimine kundervajtjes te Drejhtorise Vendore te policise Tirane per vendosjen e gjobes ne Shumen 40 000 leke dhe pezullimin e lejes se drejtimit te mjetit ndaj paditesit [REDACTED]

Gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, konstatoi kryesisht se kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe bazuar në nenet 7, 10/1 dhe 11/2 të ligjit nr. 49/ 2012 ' Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative', Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është kompetente nga pikpamja lëndore, funksionale dhe tokësore për shqyrtimin gjyqësor të saj.

Bazuar në parashikimet e nenit 12/1 të ligjit nr. 49/ 2012 ' Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' çështja u mor në shqyrtim nga trup gjykues i përbere nga një gjyqtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Bazuar në parashikimet e nenit 79/a të K.Pr.Civile, kërkesë padia dhe aktet ju njoftuan dhe Avokturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, e cila, ia delegoi te drejten e perfaqesimit dhe mbrojtjes organit administrativ.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi që:

Me date 29.01.2019 , punonjesi I policise M .Dervishi ka perpiluar procesverbalin e konstatimit te shkeljes nr. 8118560 serie, datë 29.01.2019 i ka tërhequr paditësit lejen e drejtimit te automjetit me pretendimin se drejtuesi I mjetit me date 21.01.2019 ia ka besuar dikujt I papajisur me leje drejtimi.

Me anë të vendimit nr. 1275 date 05.02.2019 'Për shqyrtimin e kundravajtjes' organi administrative pranë Drejtorise se Policise se Qarkut Tiranë ka vendosur te gjobise paditësin me 40 000 lekë gjobë dhe t'i pezulloje (anulloje) lejen e drejtimit per 12 muaj kohë, konkretisht per periudhen 29.01.2019-29.01.2020 . Paditësi, duke pretenduar se ky akt është i pabazuar në ligj dhe prova, i është drejtuar gjykatës me kërkesë padinë objekt gjykimi.

Paditesi parashtroi keto pretendime:

Vendimi per denimin me gjobe te paditësit dhe terheqjen e lejes se drejtimit është i pabazuar, pasi ai nuk eshte e vertete ai ia ka lene mjetit nje personi I papajisur me leje drejtimi pasi une mjetin e kam parkuar para shtepiese sapo jam kthyer nga puna dhe nuk e kam ditur qe personi e ka marre mjetin tim .Vendimi i organit administrative eshte i pabazuar ne prova konkrete sduke bere që ai te jete I pabazuar.

Ne kuadrin e prapësimeve perfaqësuesja e palës së paditur u shpreh se veprimet e paditësit janë në kundërshtim me nenin dhe 115/1 të ligjit nr. 8387, datë 22.07.1998 'Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë'. Agjenti verifikues kur konstaton shkeljen merr masa administrative plotesuese, që kanë të bëjnë më mjetin dhe dokumentat e tij, plotesohet raporti i shërbimit, i cili administrohet si pjese e procesverbalit te konstatimit te shkeljes. Në këto kushte vendimi i Komisionit është i bazuar dhe sanksioni i dhënë është ne përputhje te plote me parashikimet ligjore, per rrjedhoje ai duhet te lihet ne fuqi, ndersa kërkesë padia duhet rrezuar si e pabazuar ne ligj dhe prova.

Neni 115/1 pika 10 i ligjit 8378, datë 22.07.1998 'Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë' i ndryshuar parashikon: "11. Cilido që, duke zotëruar materialisht një mjet, ia beson ose ia jep ta drejtojë një personi të papajisur me lejedrejtimi, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga njëzet e pesë mijë deri në njëqind mijë lekë dhe me pezullimin e lejedrejtitimit për një vit. Kjo masë nuk zbatohet për zotëruarin material të mjetit kur ai ka bërë njoftim apo denoncim të administruar në organet e policisë për humbje, marrje (vjedhje) apo grabitje të mjetit."

Neni 201 i ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 'Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë' 'Shqyrtimi i kundërvajtjes tek organi administrativ' parashikon: "Kundërvajtjet sipas këtij Kodi shqyrtohen sipas rastiit (me përjashtim të rasteve të nenit 200) nga organi administrativ shtetëror, në territorin e të cilit është efektiv agjenti verifikues, i cili merr vendimin përkatës".

Neni 202 i ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 'Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë' 'Ankim tek organet gjyqësore' parashikon: 'Kundër vendimit të dënimit sipas nenit 201 nga organi administrativ shtetëror mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja'.

Gjykata, duke pasur parasysh pretendimet dhe prapësimet e palëve, provat e paraqitura si dhe parashikimet ligjore sipërcituar, çmon se kërkimet e paditësit Shkezen Byberi janë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

pjeserisht të bazuara.

Së pari, gjykata çmon se akti administrativ objekt gjykimi është një akt i pabazuar ne ligj dhe ne prova. Organi administrativ per shqyrtimin e kundravajtjes del me vendimin perkatës, pasi shqyrton dokumentacionin që provon shkeljen e kryer. Ne rastin konkret, per te provuar shkeljen e kryer u paraqit procesverbali i konstatimit te shkeljes, nr. 8118560 serie, datë 29.01.2019 i mbajtur nga një punonjesi i policise rrugore inspektori Marko Dervishi . Po kështu per te provuar shkeljen e kryer u paraqit dhe raport sherbimi, datë 29.01.2019, ne te cilin pasqyrohet fakti se shkelja eshte ka ndodhur me date 21.01.2019 .Nga proecverbali i konstatimit te shkeljes rezultons e shkelja ka ndodhur me date 21.01.2019 pra nga ana e punonjeist te policise rrugore ehste mbajtur nje procesverbal per konstatimin e kundravajtjes administrative me date 29.01.2019 nderkohe qe kjo ngjarje ka ndodhur me date 21.01.2019 .Gjykata cmon se procesverbali per konstatimin e kundravajtjes administrative ehste pepriuar ne kundershtim me ligjin nr 10279 date 20.01.2010 « per kundravjatjen administrative » dhe konketisht me nenin 13 te tij. Gjykata cmon se, perderisa nuk u paraqit ndonje prove tjeter e plote per te provuar shkeljen e kryer nga paditesi, ne keto kushte vendimi objekt gjykimi per pezullimin e lejes se drejtimit dhe është i pabazuar.

Së dyti dhe ne vijim te arsyetimit te pikes se pare, per sa kohe që akti është një akt i pabazuar ne ligj dhe prova (akt i paligjshem) ai duhet shfuqizuar dhe pasojat e sjella prej tij duhen rregulluar. Pala e paditur duhet t'i ktheje paditesit lejen e drejtimit te automjetit .

Së treti, ne lidhje me pretendimin e pales se paditur per shfuqizimin e procesverbalit te konsttaimit te shkeljes nr 8118560 serie, date 29.01.2019 si nje akt administrative I pavlefshem gjykata cmon se ky pretendim eshte I pambeshtetur ne ligj pasi procesverbali nuk eshte akt administrativ ne kuptim te nenit 2 te ligjit nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative ", por eshte nje akt procedural I cili nuk mund te goditet si nje akt administrativ.

Se *katerti* për sa u përket shpenzimeve gjyqësore dhe atyre për venien në ekzekutim të këtij vendimi, gjykata çmon se, perderisa kërkesë padia rezultoi pjeserisht e bazuar, bazuar ne nenin 106 të K.Pr.Civile, ato duhet te lihen sic jane bere . Këto shpenzime përbëhen nga shpenzimet e verifikuara: tarifa për ngritjen e padisë prej 3000 lekë dhe njoftimet gjyqësore 200 lekë.

Në përfundim, duke pasur parasysh gjithë sa më sipër u citua, gjykata çmon se kërkesë padia e paditësi [REDACTED] është pjeserisht e bazuar ne ligj dhe prova dhe si e tillë duhet pranuar pjeserisht nga ana e gjykates.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Gjykata bazuar në nenet 40, 41 dhe 65 të ligjit nr. 49/ 2012 ' Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëshjeve administrative'.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Vendosi:

- Pranimin pjeserisht te kërkesë padisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 1275, date 05.02.2019 te Organit Administrativ te Drejtorise Vendore te Policise Tirane.
- Detyrimin e palës së paditur Drejtorise Vendore te Policise Tirane t'i ktheheje paditesit [REDACTED] lejen e drejtimit te automjetitsidhe tete piket e lejes se drejtimit te mjetit .
- Rrezimin e padise per pjesen tjetër te saj sit e pabazuar ne prova dhe ne ligj.
- Shpenzimet gjyqësore sic jane bere .
- Ky vendim pasi te marre forme te prere perben titull ekzekutiv dhe eshte i ekzekutueshem nga sherbimi permbarimor gjyqesor privat ose shteteror.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga dita e neserme e komunikimit te vendimit te arsyetuar.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.